

PROCESVERBAL
nga seanca e 27-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
të mbajtur me datë 28.07.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Gordana Majnova (pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, Magdalena Davidovska-Dovleva, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 27-të të Këshillit. Seanca filloi në ora 12:10 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 7-të publike e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur me datë 16.07.2026.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i seancës së 25-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur me datë 16.07.2026.
3. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 26-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur me datë 16.07.2026.
4. Shqyrtimi i raporteve tremujore mbi punën e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 prill deri më 30 qershor 2026.
5. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetimit televiziv të ShTR Television Makpetrol ShPKNJ P Shkup.
6. Propozim-aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të ShTR Protel ShPKNJ P Probishtip.
7. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës pronësore të RA Nasha TV ShPKNJ P Shkup.

8. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR RFM ShPKNjP Shkup.

9. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj operatorit Viva Net ShPK Berovë, për shkelje të nenit 141 të LShMAAV-së.

10. Propozim për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e 4 (katër) aksesëve të përdoruesve në bazën elektronike të të dhënave të rregulloreve në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

11. Propozim për dhënien e miratimit për miratimin e vendimit për furnizim të shërbimit - mirëmbajtjen e aparateve të kafes për nevojat e Agjencisë.

12. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: hulumtim - analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e prezantimit dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve në vitin 2026.

13. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: Çertifikata digjitale.

14. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe, me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga Zirjeta Jajaga, miratoi Propozim-procesverbalin nga seanca e 7-të publike e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur me datë 16.07.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli shqyrtoi dhe, me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga Zirjeta Jajaga, miratoi Propozim-procesverbalin nga seanca e 25-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur me datë 16.07.2026.

Pika 3

Këshilli shqyrtoi dhe, me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga Zirjeta Jajaga, miratoi Propozim-procesverbalin nga seanca e 26-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur me datë 16.07.2026.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë, Dragica Ljubevska, prezantoi Informacionin mbi zbatimin e aktiviteteve të Agjencisë në tremujorin e kaluar, në pajtim me Programin Vjetor të Punës. Ajo informoi se në periudhën raportuese, Agjencia ka kryer një sërë aktiviteteve në kuadër të kompetencave të saj programore, administrative dhe të tjera. Sa i përket detyrimeve programore dhe administrative, janë kryer disa mbikëqyrje të rregullta për detyrime të ndryshme ligjore. Gjatë mbikëqyrjeve të rregullta programore të kryera në televizionet kombëtare Alsat-M, Telma, Alfa, Kanal 5 dhe Sitel, si dhe në shërbimet programore televizive dhe radio të shërbimit publik radiodifuziv, janë konstatuar shkelje në TV Alsat-M, TV Telma dhe RTM3. Në televizionin TV

Alsat-M është konstatuar shkelje e rregullave për sponsorizim, përkatësisht detyrimin që programet e sponsorizuara të mos nxisin blerje direkte ose marrje me qira të mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht përmes rekomandimit të veçantë promovues. Tek TV Telma u konstatua shkelje në lidhje me kushtet për reklamim dhe teleshopping, ndërsa tek RTM3 u konstatua se nuk ishin siguruar të dhënat që duhet të ishin të disponueshme për përdoruesit. Në periudhën raportuese, u kryen edhe tre mbikëqyrje të rregullta administrative mbi të gjithë 90 transmetuesit, në lidhje me disa detyrime ligjore. U konstatua se ShTR Television Plus nuk e përmbushi detyrimin për të paraqitur të dhëna mbi strukturën pronësore, kryeredaktorin, burimet e financimit dhe të ardhurat dhe shpenzimet totale në vitin e kaluar. TV 24 Vesti e përmbushi të njëjtin detyrim pjesërisht, përkatësisht nuk i paraqiti të gjitha të dhënat dhe dokumentet e nevojshme. Përveç kësaj, u konstatua se TV Plus nuk e përmbushi detyrimin për të paraqitur raport mbi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim televiziv për vitin 2025. Lidhur me njoftimin e paraqitur për ndryshim në strukturën pronësore të ShTR Jon-radio ShPK Strugë, pas zbatimit të procedurës dhe kontrolleve të kryera, u konstatua se ndryshimi i propozuar nuk shkel dispozitat ligjore për përqendrimin e paautorizuar mediatik, prandaj Këshilli i Agjencisë miratoi vendim me të cilin miratoi ndryshimin në strukturën pronësore të transmetuesit. Ljubevska informoi gjithashtu se janë kryer 22 mbikëqyrje të rregullta ndaj operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, në lidhje me detyrimet për përdorimin e gjuhës në program, regjistrimin e detyrueshëm të shërbimeve programore që ritransmetohen dhe detyrimin që paketa programore të përmbajë detyrimisht dhe pa pagesë shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv. Gjatë mbikëqyrjeve, u konstatuan shkelje në dy operatorë në lidhje me ritransmetimin e shërbimeve programore të paregjistruara. Një mbikëqyrje e kontrollit programor u krye edhe mbi Total TV, gjatë së cilës u konstatua se është vepruar në pajtim me aktvendimin e shqiptuar. Lidhur me botuesit e mediave të shtypit, u kryen tre mbikëqyrje të rregullta, një e jashtëzakonshme dhe një mbikëqyrje kontrolli, gjatë të cilave nuk u konstatuan shkelje. Lidhur me botuesit e mediave online – portaleve të internetit, u krye një mbikëqyrje e rregullt dhe dy mbikëqyrje kontrolli, gjatë të cilave nuk u konstatuan shkelje. Gjatë periudhës raportuese, janë paraqitur katër kërkesa për regjistrim në Regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale me Kërkesë, të cilët janë persona fizikë. Ljubevska informoi se gjatë tremujorit janë mbajtur takime të shumta nga drejtori dhe të punësuarit në shërbimin profesional me përfaqësues të institucioneve, organizatave dhe organeve lidhur me sferën mediatike. U realizuan edhe disa aktivitete ndërkombëtare, si dhe aktivitete lidhur me përgatitjen e kontributeve në kuadër të procesit të integritetit evropian. Në pjesën e transparencës në punë, Agjencia publikoi disa njoftime publike, të cilat u publikun edhe në faqen zyrtare të Agjencisë në Facebook, së bashku me njoftimet për seancat e Këshillit. Rregullisht është përditësuar faja e internetit të Agjencisë, në gjuhën maqedone, anglisht dhe shqip. Lidhur me aktivitetet e revizionit, Ljubevska informoi se janë kryer aktivitetet e planifikuara për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna pas revizioneve të kryera në Agjenci për vitin 2025, përkatësisht i ashtuquajturit revizion "follow-up". Njëkohësisht, kishte filluar edhe zbatimi i revizionit të procesit të monitorimit mbi përmbajtjet e transmetuara nga radiodifuzerët gjatë zgjedhjeve lokale. Lidhur me masat e marra në periudhën raportuese, u miratuan tetë aktvendime për shqiptimin e masës paralajmërim publik për katër transmetues, dy aktvendime për shqiptimin e masës paralajmërim publik për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore për tre operatorë, si dhe tre aktvendime për shqiptimin e masës paralajmërim publik për tre botues të mediave online - portaleve të internetit. Së fundmi, Ljubevska theksoi se aktivitetet e prezantuara paraqesin një sublimim të aktiviteteve të realizuara të Agjencisë

në tre muajt e fundit, dhe më shumë detaje përmban materiali i paraqitur për seancë, së bashku me Raportin Financiar për tremujorin e kaluar.

Pika 5

Në lidhje me propozim-vendimin për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizion Makpetrol ShPKNJ P Shkup, drejtori i ASHMA-së, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se LShMAAV-së përcakton që lejet për transmetim televiziv dhe radio të shoqërive tregtare radiodifuzive dhe institucioneve jofitimprurëse të transmetimit jepet për një periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh me mundësi për vazhdimin e lejes, me kusht që transmetuesi të mos ketë shkelur Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Pas mbikëqyrjes së kryer të punës së transmetuesit gjatë kohëzgjatjes së lejes, ASHMA konstatoi se ShTR Televizioni Makpetrol ShPKNJ P Shkup i plotëson kushte, përkatësisht gjatë kohëzgjatjes së Lejes nuk ka kryer shkelje serioze të cekura në nenin 79, paragrafi (4) të LShMAAV-së dhe propozon që e njëjta të vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, përkatësisht nga data 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizioni Makpetrol ShPKNJ P Shkup.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 6

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Propozim-vendimin për fshirjen e ShTR Protel ShPKNJ P Probishtip nga regjistri i radiodifuzerëve.

Këshilli njëzëri miratoi aktvendim për fshirjen e Shoqërisë për Veprimtari Radiodifuzive Protel SHPKNJ P Probishtip nga regjistri i radiodifuzerëve.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Spektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Dovleva-Davidovska, shpjegoi propozimin për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR Nasha TV ShPKNJ P Shkup, duke informuar se Agjencia ka marrë njoftim për ndryshimin e të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore. Për të shqyrtuar nëse ndryshimet e propozuara në strukturën pronësore të transmetuesit do të krijonin përqendrim mediatik të paautorizuar, d.m.th. nëse janë në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LShMAAV-së, Agjencia siguroi të dhëna nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat është e qartë se personi juridik Shoqëria për tregti dhe shërbime Alo media sistem ShPKNJ P Shkup nuk figuron si pronar i shoqërive të tjera tregtare;

drejtues i Shoqërisë, personi fizik Dragan Llaziq, nuk figuron si themelues dhe/ose drejtues i shoqërive të tjera tregtare; themeluesi i Shoqërisë, personi juridik Alo media sistem ShPK Beograd, nuk figuron si pronar i shoqërive të tjera dhe themeluesi - personi fizik Sasha Bllagojeviq, nuk figuron si pronar dhe/ose drejtues i asnjë shoqërie tregtare. Përveç kësaj, Agjencia ka kryer kontroll edhe në Regjistrin e pronarëve përfitues të mbajtur nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga i cili mund të konstatohet se ky person është evidentuar si pronar përfitues vetëm i personit juridik Shoqërisë për tregti dhe shërbime Alo media sistem ShPKNjP Shkup.

Këshilli njëzëri votoi kundër ndryshimit të strukturës pronësore të ShTR Nasha TV ShPKNjP Shkup.

Pika 8

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Dovleva-Davidovska, në lidhje me propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR RFM ShPKNjP Shkup, deklaroi se situata është e njëjtë si me ShTR Nasha TV ShPKNjP Shkup.

Këshilli njëzëri votoi kundër ndryshimit të strukturës pronësore të ShTR RFM ShPKNjP Shkup.

Pika 9

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Dovleva-Davidovska, shpjegoi propozimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik të operatorit Viva net ShPK Berovë, për shkelje të nenit 141 të LShMAAV-së. Ajo shpjegoi se gjatë mbikëqyrjes së rregullt programore, të kryer më 22.07.2026, u konstatua se operatori në shërbimin programor për përdoruesit e tij ritransmetoi shërbimin programor "FEN TV", që nuk është mbuluar nga çertifikata për regjistrimin e shërbimeve programore të lëshuar nga Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, që është në kundërshtim me nenin 141, paragrafi (13) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Është propozuar të miratohet aktvendim për paralajmërim publik dhe për përjashtimin e ritransmetimit të shërbimit programor, në të cilin operatorit Viva Net ShPK Berovë urdhërohet që menjëherë, pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me nenin 141, paragrafi (13) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Kryetari i Këshillit të Agjencisë, mr. Sasho Stefanovski, sugjeroi që përveç kontrolleve të rregullta, të ketë edhe kontrolle të jashtëzakonshme mbi punën e këtij operatori.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-2862/1 të datës 23.07.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive-operatorit të rrjetit kabllor Viva Net ShPKNjP Berovë t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 141, paragrafi (13) të LShMAAV-së dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (teksti i pastruar) nr.01-4241/1 të datës 01.10.2025, urdhërohet që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për paralajmërim publik dhe për përjashtimin e ritransmetimit të shërbimit programor, të harmonizojë punën e saj me LShMAAV-së.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit të caktuar të mbikëqyrjes.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar paralajmërim publik (tërësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin do ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 10

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e 4 (katër) qasjeve të përdoruesve në bazën elektronike të të dhënave të rregulloreve në "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", për periudhë prej 12 muajsh, për të cilën është e nevojshme të sigurohen mjete në shumë prej 46.000,00 denarësh me TVSH të llogaritur prej 18%.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, pyeti nëse këto ishin qasje të reja të përdoruesve, me ç'rast Mitrevska sqaroi se këto ishin qasje ekzistuese, përdorimi i të cilave duhet të vazhdohet. Nga katër qasjet, tre përdoren nga të punësuarit në sektorin për çështje juridike dhe furnizime publike, dhe një përdoret nga një punonjës në Sektorin për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit.

Këshilltarja Cvetanka Minovska pyeti nëse katër qasjet e listuara përfshijnë edhe qasjen që duhet të përdorë këshilltarja Gordana Majnova. Mitrevska sqaroi se qasja e Majnovës është planifikuar dhe do t'i vihet në dispozicion, por për shkaqe teknike ende nuk është aktivizuar.

Përveç kësaj, Mitrevska informoi se Agjencia tashmë përdor edhe dy qasje të tjera, kështu që me rinovimin e katër qasjeve shtesë, do të ketë gjithsej gjashtë qasje. Duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të qasjeve, Agjencia do të jetë në gjendje t'i përdorë me çmim më të favorshëm.

Këshilli i Agjencisë e miratoi propozimin me pesë vota "pro" dhe një votë "abstenim" nga këshilltarja Cvetanka Minovska.

Pika 11

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, në lidhje me propozimin për dhënien e pëlqimit për miratimin e vendimit për furnizimin e shërbimit: mirëmbajtjen e aparateve të kafes për nevojat e Agjencisë, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike, në shumë prej 60.000,00 denarë pa TVSH, për periudhë prej 1 (një) viti, shpjegoi se Agjencia për nevojat e veta përdor aparate për kafe (kafemate) të blera në vitin 2015. Duke pasur parasysh se periudha e garancisë dhe vlefshmëria e marrëveshjes për mirëmbajtjen e tyre ka skaduar, është e nevojshme të sigurohet kryerja e shërbimit - mirëmbajtja e aparateve të kafes si servisim i rregullt mujor.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë të miratojë Vendim me të cilin miraton mjete financiare në shumë prej 60.000,00 denarësh pa TVSH, për periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, për furnizim me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike - për shërbimin: mirëmbajtja e aparateve të kafes në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Për realizimin e furnizimit të lartpërmendur, mjetet janë siguruar nga Planin Financiar i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 12

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: hulumtim - analizë të çështjeve gjinore dhe mënyrës së prezantimit dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve. Ajo shpjegoi se zbatimi i kësaj procedure është detyrim ligjor i Agjencisë që buron nga Ligji për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat dhe zbatohet çdo vit që nga viti 2012. Ajo theksoi se furnizimi do të zbatohet si procedurë e hapur e thjeshtuar dhe do të fillojë me publikimin e njoftimi në sistemin elektronik për furnizime publike dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: hulumtim – analizë të çështjeve gjinore dhe mënyrës së prezantimit dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve në vitin 2026.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik - shërbim: hulumtim - analizë e çështjeve gjinore dhe mënyra e prezantimit dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve në vitin 2026 është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-2743/1 të datës 13.07.2026 ndërsa mjetet janë siguruar nga Planin Financiar i Agjencisë për vitin 2026.

Pika 13

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: Çertifikata digjitale. Ajo shpjegoi se furnizimi po zbatohet me qëllim zgjatjen e vlefshmërisë së çertifikatave ekzistuese digjitale dhe nevojën për lëshimin e çertifikatave të reja digjitale për nënshkrim dhe blerjen e tokenëve të rinj. Zbatimi i kësaj procedure është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr.05-2743/1 të datës 13.07.2026, ndërsa mjetet janë siguruar nga Planin Financiar i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: çertifikata digjitale.

Pika 14

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani